

V E N D I M
Nr.319, datë 21.6.1994

**PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË PASTRIMIT
DHE GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Organet e pushtetit lokal me fondet buxhetore të caktuara të bëjnë prokurimin e shërbimeve të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave nëpërmjet kontratave të sipërmarrjes me ndërmarrje dhe firma të ndryshme. Këto shërbime përfshijnë a) pastrimin e rrugëve; b) grumbullimin e mbeturinave nga vendet e depozitimit; dhe c) menazhimi i fushave të grumbullimit të këtyre mbeturinave.

2. Procedurat e dhënies në sipërmarrje të këtyre shërbimeve do të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993 "Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore".

3. Organet e pushtetit lokal bëjnë ndarjen e territoreve që kanë në administrim në zona për pastrimin e rrugëve dhe grumbullimin e mbeturinave. Organet e pushtetit lokal organizojnë prokurime të veçanta për sipërmarrjen e shërbimeve për secilën zonë. Kontratat do të lidhen në bazë të procedurave të prokurimit me kontraktues të kualifikuar dhe do të jenë me afat 3 deri 5 vjet.

4. Organet e pushtetit lokal do të organizojnë konkurim të veçantë për administrimin e fushave të grumbullimit të mbeturinave. Kontratat do të lidhen me afat 5-vjeçar.

5. Kontratat për shërbimet e përmendura në pikat 3 dhe 4 do të përcaktojnë standardet e kryerjes së shërbimeve, duke përfshirë qëllimin e punës, frekuencën e shërbimeve, cilësinë e punës së kryer dhe sanksionet për moskryerjen e punimeve sipas këtyre standardeve.

6. Kontratat për shërbimet publike do të lidhen pasi të jenë kontrolluar dhe miratuar nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

7. Organet e pushtetit lokal duhet të caktojnë një kontrollor të zbatimit të kontratave, i cili do të paguhet nga buxheti i caktuar për shërbimin e pastrimit. Kontrollori do të veprojë në bazë të një manuali, ku do të specifikohet se si do ta kryejë kontrollin për çdo kontratë dhe sa shpesh do të kryhen këto kontrolle. Kontrollori harton raporte mujore për mangësitë dhe sanksionet që propozohen, të cilat ia paraqet këshillit bashkiak.

8. Kontrollori i kontratave do të përgatitë edhe një raport vjetor për Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit. Raporti do të përfshijë kopje të të gjitha kontratave të lidhura, kopje të raporteve të hartuara për këshillin bashkiak dhe bilancin e shpenzimeve të fondeve të buxhetit. Ministria, nga ana e vet, përgatit një përmbledhje të raporteve dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave, së bashku me propozimet e saj për ndryshime të mundshme në procedura ose buxhet.

9. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të nxjerrë udhëzimet e nevojshme, si dhe të miratojë kontrata tip e manuale operative për bashkitë. Ministria të ndihmojë organet e pushtetit lokal që të përdorin kontrata tip në përputhje me kushtet e tyre, si dhe të zgjidhin problemet me kontraktuesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi